

URDHËR
Nr. 2, datë 23.10.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Kuvendi i Shqipërisë, për procedurat e prokurimit publik, te z. Genci Gjonçaj, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi